Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

Prishtinë, 21 shtator 2023
Kodi i ZRRE-së: V_1769_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 6, paragrafi 6.4, në Marrëveshjen kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës,
- Dispozitat e Nenit 44 të Rregullores së Komisionit Europian (EU) 2015/1222 CACM (Alokimi i Kapaciteteve dhe Menagjimi i Kongjestionit),
- Vendimin V_1332_2020 të datës 10 dhjetor 2020,
- Vendimin V_1637_2022 të datës 27 dhjetor 2022,
- Vendimin V_1638_2022 të datës 27 dhjetor 2022
- Vendimin V_1748_2023 të datës 17 korrik 2023,
- Kërkesën e KOSTT SH.A. nr. 1452 të datës 31.07.2023 për miratimin e dokumenti Rregullat për Alokimin në Hije për kufirin Kosovë – Shqipëri,

në seancën e mbajtur me datë 21 shtator 2023 nxori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHEN** - "Rregullat për Alokimin në Hije për kufirin mes Republikës së Kosovës – Republikës së Shqipërisë.

A r s y e t i m

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 31.07.2023 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A. për shqyrtim dhe aprovim të Rregullave për Alokim në Hije për kufirin mes Republikës së Kosovës – Republikës së Shqipërisë .
- KOSTT SH.A më datë 09.08.2023 pas kërkesës së ALPEX SH.A. – Dega në Kosovë dhe dakordimit mes KOSTT, OST dhe SEE CAO, ka dërguar versionin final të dokumentit me disa përmirësime rreth afateve kohore.

- Rregullat për Alokimin në Hije është zhvilluar nga SEE CAO në bashkëpunim me OST dhe KOSTT, dhe objektivi kryesor i dokumentit është alokimi i kapaciteteve në mënyrë efikase, transparente dhe jo-diskriminuese në rastet kur bashkimi i tregjeve të energjisë elektrike mes Kosovës dhe Shqipërisë nuk është në gjendje të prodhojë rezultate, dhe përmbajnë termat dhe kushtet për alokimin e të Drejtave Ditore të Transmetimit në kufijtë në mes të OST (Shqipëri) dhe KOSTT (Kosovë), si procedurë rezervë për bashkimin e tregut një ditë para.
- SEECAO, OST, KOSTT, ERE dhe ZRRE në përputhje me kërkesat ligjore, kanë vendosur Rregullat për Alokim në Hije në konsultim publik, ku palët e interesuara kanë pasur mundësi të paraqesin komentet dhe qëndrimet e tyre lidhur me çështjet e trajtuara në këto dokumente.
- Pas përfundimit të konsultimit publik, dhe pas përfshirjes së komenteve të palëve, dokumenti është përgatitur për shqyrtim dhe miratim në ZRRE.
- Bordi i ZRRE, pas vlerësimit dhe analizimit ka konstatuar që Rregullat për Alokimin në Hije janë konform kërkesave ligjore, dhe ka vlerësuar se i njëjti është i domosdoshëm për funksionimin e sigurt të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike - ALPEX, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Shtojcë: - Rregullat për Alokimin në Hije.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Arta Isufi, anëtare

Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi dhe dokumenti i dërgohet:

- KOSTT SH.A.,
- ALPEX, dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.